




Wondergarden
EARLY CHILDHOOD TIRANA

Paketa e Regjistrimit

Wondergarden – Programi më i vlerësuar edukativ në SHBA



www.wondergardentirana.com

Wondergarden: Lider në edukimin e hershëm të fëmijëve!



Në Wondergarden jemi krenarë që jemi ndër qendrat e para që sjellin standarde të larta ndërkombëtare në kujdesin dhe edukimin e fëmijërisë së hershme, të përshtatura me nevojat e fëmijëve në Shqipëri, përmes një programi amerikan të certifikuar dhe të testuar.

- **Cilësi dhe siguri në çdo hap**, ne ndjekim standarde ndërkombëtare për cilësinë e shërbimeve, mjedisin dhe sigurinë e fëmijëve, përmes protokolleve të qarta dhe trajnimeve të vazhdueshme për stafin tonë.
- **Zhvillim përmes lojës dhe udhëheqjes së fëmijës**, fëmijët tanë angazhohen në projekte të udhëhequra nga vetë ata, ku luajnë, eksplorojnë dhe mësojnë në një ambient që frymëzon kreativitetin dhe mendim të pavarur.
- **Fokus në inteligjencën emocionale**, çdo klasë përfshin “këndin e qetësisë”, një vend ku fëmijët mësojnë të vetë-rregullojnë emocionet. Stafi ynë i mirëqenies dhe mbështetja për prindërit janë pjesë e përditshmërisë sonë.
- **Vlerësime nga komuniteti dhe institucionet**, jemi të vlerësuar për qasjen tonë inovative nga liderë dhe institucione të edukimit, si brenda vendit ashtu edhe ndërkombëtarisht..
- **Ambiente për zhvillim fizik dhe social**, çdo degë Wondergarden përfshin një qendër aktiviteteve fizike dhe lojërash të strukturuar që ndihmojnë në zhvillimin motorik dhe shoqëror të fëmijëve.





Misioni I Wondergarden

Vizioni ynë

Të jemi model udhëheqës në edukimin e hershëm të fëmijërisë, duke ofruar përkujdesje dhe mësim me cilësi të lartë, të bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe qasjen amerikane të zhvillimit gjithëpërfshirës të fëmijës.

Misioni ynë

“Mbjellim fara suksesi”

Në Wondergarden, synojmë t’u japim çdo fëmijë mundësi të menduara me kujdes për të zhvilluar potencialin e tij/saj, brenda një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe mbështetës. E arrijmë këtë përmes përforsimit pozitiv, modelimit të sjelljes dhe një kurrikule që ngjall kureshtje, habi dhe dashuri për të mësuar gjatë gjithë jetës.

Vlerat tona

- Respekt dhe Integritet
- Barazi dhe Diversitet
- Të Drejtat dhe Përgjegjësitë
- Inovacion dhe Cilësi



Përkushtimi ynë

- Stafi jonë : Përkushtim ndaj mirëqenies dhe zhvillimit të stafit tonë, sepse edukatorët tanë të lumtur rrisin fëmijë të lumtur.
- Bashkëpunëtorët tanë : Ndërtojmë marrëdhënie të forta me prindërit, partnerët dhe komunitetin për të rritur së bashku një brez të shëndetshëm.
- Mjedisi : Mendojmë dhe veprojmë me kujdes për natyrën: Rimendojmë, Reduktojmë, Ripërdorim, Riciklojmë.
- Performanca : Bëjmë gjërat siç duhet - me përkushtim, etikë dhe efikasitet.
- Inovacioni : Jemi gjithmonë të hapur ndaj iniciativave të reja dhe i vlerësojmë kontribuesit që sjellin ide të freskëta.



**Kurrikula EYFS në Wondergarden-
Edukim nga lindja deri në
moshën 4 vjeç.**



Mirë se vini në Wondergarden, një ambient i ngrohtë dhe frymëzues ku çdo fëmijë mëson, rritet dhe lulëzon përmes përvojës, lojës dhe dashurisë. Ne ndjekim një qasje të avancuar të edukimit të hershëm, të bazuar në standardet amerikane për zhvillimin e fëmijërisë së hershme (Early Childhood Education Stage), që siguron një themel të fortë për zhvillimin, të nxënës dhe kujdesin ndaj fëmijëve nga lindja deri në moshën 4 vjeç

Çfarë është Kurrikula për Edukimin e Hershëm në Wondergarden?

Në Wondergarden, ndjekim një kornizë të plotë të zhvillimit të hershëm të fëmijëve, të ndërtuar sipas praktikave më të mira amerikane në edukimin nga lindja deri në moshën 5 vjeç. Qasja jonë është e balancuar dhe e personalizuar, duke përfshirë 7 fusha kryesore të zhvillimit dhe të nxënës, që shërbejnë si bazë për formimin e fëmijës në aspektin kognitiv, fizik, emocional dhe krijues.

Fushat Themelore të Zhvillimit:

- **Komunikimi**
- **Zhvillimi Personal, Shoqëror dhe Emocional**
- **Zhvillimi Fizik**

Fushat specifike të të mësuarit:

- **Letërsia (Shkrim & Lexim)**
- **Matematika**
- **Të Kuptuarit e Botës**
- **Artet Shprehëse dhe Dizajni**

Komunikimi: Krijojmë një botë të mbushur me fjalë, ku fëmijët ndihen të lirë të shprehen, të dëgjojnë me kujdes dhe të flasin me besim përmes tregimeve, lojërave me role dhe bisedave të përbashkëta.

Zhvillimi Personal, Shoqëror dhe Emocional : Mbështesim mirëqenien emocionale të fëmijëve duke ndërtuar marrëdhënie të ngrohta, duke promovuar vetëkontrollin dhe duke forcuar ndjenjën e përkatësisë dhe vetëvlerësimit.

Zhvillimi Fizik: Nxsisim zhvillimin motorik përmes lojës aktive, eksplorimit në natyrë dhe aktiviteteve të strukturuar si vallëzimi, joga dhe lojërat manuale.

•**Letërsia (Shkrim & Lexim):** Nxsisim dashurinë për librin që në hapat e parë, përmes leximeve të përbashkëta, tregimeve të bukura dhe ushtrimeve të para me shkronja dhe tinguj.

•**Matematika:** Zhvillojmë të menduarin matematikor përmes lojërave konkrete, aktiviteteve praktike dhe sfidave që i mësojnë fëmijët për numrat, format, hapësirën dhe matjet.

•**Të Kuptuarit e Botës:** Ushqejmë kureshtjen natyrore të fëmijëve për botën përreth duke i ekspozuar ata ndaj kulturave të ndryshme, mjediseve, eksperimenteve dhe zbulimeve reale..

•**Artet Shprehëse dhe Dizajni:** Nxsisim fëmijët të flasin me ngjyra, tinguj dhe role, duke i udhëhequr drejt një bote të pasur krijuese dhe të bukur artistike.



Dokumentat e Regjistrimit



Prindërit ose kujdestarët ligjorë duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë paketën e regjistrimit të ofruar nga Wondergarten, së bashku me dokumentet e mëposhtme, të cilat duhet të dorëzohen përpara fillimit të fëmijës në institucion::

- **Një kopje të pasaportës së vlefshme të fëmijës dhe të prindërve**
- **Kopje të kartës së identitetit për fëmijën dhe prindërit, si dhe për çdo të rritur shtesë të autorizuar për të sjellë apo marrë fëmijën (pjesa përpara dhe mbrapa)**
- **Tre fotografi me ngjyra të formatit pasaporte të fëmijës**
- **Një fotografi pasaporte e nënës dhe babait, si dhe e çdo të rrituri shtesë të autorizuar për të sjellë apo marrë fëmijën.**
- **Kopje të librezës së vaksinimit të fëmijës**
- **Deklaratë miratimi për vlerësim të nevojave (nëse aplikohet)**

Kopje të çdo raporti mjekësor, vlerësimi të mëparshëm dhe/ose plani mbështetës për fëmijë me nevoja të veçanta (nëse aplikohet)





Father's Photo



Mother's Photo



Student's Photo



Additional Adult



Ju lutemi dërgoni një fotografi dixhitale të secilit në email.

Formulari i Regjistrimit

Detajet

Emri			Mbiemri:			
Gjinia: M ☐ F ☐	Ditëlindja:			Atësia:		
Shtetësia:			Gjuha e parë e folur:			
			Gjuhë të tjera:			
Adresa (Residential):						
Nr i Kartës së ID:			E- mail ose Telefon:			

Informacion mbi Familjen:

Emri I babait:			Mbiemri:		
Numeri i Telefoni:			Email:		
Adresa:			P.O. BOX:		
Emri I nënës :			Mbiemri:		
Numeri i Telefoni:			Email:		
Adresa:			P.O. BOX:		

Detaje shtesë

Kontaktet e Emergjencës

Emri:		Name:	
Tel:		Tel:	
Email:		Email:	
Address:		Address:	
Marrëdhënia me fëmijën:		Marrëdhënia me fëmijën:	

Detaje të tjera

--	--

Data e Fillimit:

Komente

Transport: ☐ Po ☐ Jo

--	--



Marrëveshje dhe Përgjegjësi



Duke regjistruar fëmijën tim në Kopsht, pranoj dhe pajtohem me kushtet dhe rregullat e mëposhtme::

Regjistrimi dhe Tarifat:

- Prindi/prindërit bien dakord të regjistrojnë fëmijën në programin e Kopshtit sipas orarit të përcaktuar.
- Prindi/prindërit bien dakord të paguajnë tarifën e shkollimit dhe çdo pagesë shtesë sipas strukturës së tarifave të Kopshtit
- Prindi/prindërit njohin dhe pranojnë që tarifën e shkollimit dhe çdo pagesë shtesë janë të përcaktuara nga Kopshti dhe mund të ndryshohen sipas politikave të brendshme të institucionit. Çdo ndryshim në tarifën e shkollimit do t'u komunikohet prindërve me kohë.

Pjesëmarrja dhe Mungesat:

- Prindi/prindërit bien dakord të sigurojnë ndjekjen e rregullt të programit nga fëmija në Kopsht.
- Prindi/prindërit bien dakord të informojnë Kopshtin menjëherë në rast mungese të fëmijës dhe të dorëzojnë dokumentacionin e nevojshëm në rast mungesash të zgjatura.

Çështje Shëndetësore dhe Mjekësore:

- Prindi/prindërit bien dakord të ofrojnë informacion të saktë shëndetësor dhe mjekësor për fëmijën pranë Kopshtit.
- Prindi/prindërit bien dakord të mbajnë fëmijën në shtëpi nëse nuk ndjehet mirë dhe të informojnë Kopshtin në rast të ndonjë sëmundjeje ngjitëse.
- Kopshti ruan të drejtën të mos pranojë fëmijën në ambientet e tij nëse ai/ajo shfaq simptoma sëmundjeje, deri në momentin kur një profesionist mjekësor konfirmon se fëmija është i/e aftë të rikthehet..

Mbështetje për fëmijët me nevoja të veçanta:

- Pranimi i fëmijëve në kopsht, të cilët kanë nevojë për një mësues mbështetës ose ndihmës në mësim, do të bëhet me kusht që prindërit të sigurojnë punësimin e këtij personi mbështetës.
- Prindërit do të nënshkruajnë një Marrëveshje Mirëkuptimi (MoU) me kopshtin, nëse fëmija i tyre ka nevojë për shërbimet e një ndihmësi në të nxënë..
- Prindërit do të informohen për një program përgatitor për shkollë, nëse fëmija i tyre ka nevojë për ndërhyrje të individualizuara për ta ndihmuar në përgatitjen për shkollën.



Komunikimi:

- Prindi/prindërit bien dakord të mbajnë një komunikim të hapur me Kopshtin në lidhje me përparimin e fëmijës, shqetësime apo çështje të tjera të rëndësishme.
- Kopshti angazhohet të informojë rregullisht prindërit mbi aktivitetet dhe zhvillimin e fëmijës gjatë qëndrimit në Kopsht.



Sendet Personale:

- Prindi/prindërit bien dakord të vendosin emrin e fëmijës në të gjitha sendet personale që sjellin në Kopsht.
- Kopshti nuk mban përgjegjësi për humbjen apo dëmtimin e sendeve personale të fëmijës.

Rregullat dhe Procedurat e Kopshtit:

- Prindi/prindërit njohin se kanë marrë dhe shqyrtuar rregullat dhe procedurat e Kopshtit.
- Prindi/prindërit bien dakord të respektojnë rregullat dhe procedurat e Kopshtit lidhur me regjistrimin, pjesëmarrjen, shëndetin, sigurinë dhe sjelljen.
- Prindi/prindërit kuptojnë se nëse respektojnë rregullat dhe procedurat e Kopshtit, stafi nuk do të mbahet përgjegjës për asnjë çështje që lind brenda fushës së detyrave të tyre.
- Kopshti rezervon të drejtën për të përditësuar rregullat dhe procedurat, dhe prindërit do të njoftohen për çdo ndryshim në kohë.

Anulimi i Regjistrimit:

- Prindi/prindërit mund të anulojnë këtë Marrëveshje me një njoftim me shkrim një muaj para, të dërguar pranë Kopshtit.
- I Në rast anulimi, prindi/prindërit bien dakord të paguajnë çdo detyrim financiar që kanë ndaj Kopshtit..

Pranimi:

Palët me këtë deklarojnë se kanë lexuar dhe kuptuar kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe bien dakord të përmbahen ndaj dispozitave të saj..

Nënshkrimi(i) i Prindit/Mbikëqyrësit: _____

Nënshkrimi i Përfaqësuesit të Kopshtit: _____

Data: _____





Leje për Pjesëmarrje në

Seancat e Gatimit janë një pjesë thelbësore e programit edukativ të Wondergarden në vitet e hershme të fëmijërisë.

Këto aktivitete janë menduar për të ofruar përvoja të pasura mësimore për fëmijën tuaj, duke nxitur kuriozitetin, zhvillimin e aftësive praktike dhe kënaqësinë nga të mësuarit përmes përfshirjes aktive. Ne besojmë se gatimi luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e tyre të gjithanshëm - duke ndihmuar në ndërtimin e vetëbesimit, pavarësisë dhe bashkëpunimit me të tjerët.

Rëndësia e Gatimit për Vitet e Hershme të Fëmijërisë

Zhvillimi Social dhe Emocional: Aktivitetet e gatimit nxisin punën në ekip, bashkëpunimin, ndarjen, si dhe zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale si durimi dhe qëndrueshmëria.

Aftësitë për Jetën: Gatimi i njoh fëmijët me aftësi të rëndësishme jetësore si përgatitja e ushqimit, siguria në kuzhinë dhe kuptimi i ushqyerjes së shëndetshme.

Zhvillimi Matematikor: Gatimi përfshin aplikime praktike të koncepteve matematikore, duke ofruar përvoja të drejtpërdrejta me matjet dhe sasi të, duke mbështetur zhvillimin matematikor.

Gjuha dhe Komunikimi: Seancat e gatimit nxisin komunikimin, bashkëpunimin dhe zgjerimin e fjalorit, duke përmirësuar aftësitë gjuhësore dhe komunikative.

Ndërgjegjësimi Kulturor: Përmes gatimit, fëmijët njihen me ushqime dhe tradita të ndryshme gatimi nga kultura të ndryshme, duke promovuar vlerësimin dhe respektin për diversitetin kulturor.

Zakone të Shëndetshme: Pjesëmarrja në aktivitetet e gatimit ndihmon fëmijët të zhvillojnë kuptimin për zakonet e shëndetshme të ushqyerjes dhe rëndësinë e zgjedhjeve të duhura ushqimore për mirëqenien e përgjithshme.

Duke firmosur më poshtë, ju jepni pëlqimin që fëmija juaj të marrë pjesë në seancat tona të gatimit. Ju lutemi të na informoni për çdo shqetësim shëndetësor specifik, si alergjitë ndaj ushqimeve të caktuara ose ndonjë nevojë dietike që fëmija juaj mund të ketë, për shembull vegetarizëm apo intolerancë ndaj laktozës, që duhet të kemi parasysh.

Nevojat dietike:

Alergjitë:

Nënshkrimi i Prindit/Prindërve ose Kujdestarit: _____



Emri i Fëmijës: _____

Leje për Pjesëmarrje në Pishinën



Lojërat me ujë në pishinën e notit janë një pjesë e rëndësishme e programit tonë edukativ në Wondergarden për Vitet e Hershme të Fëmijërisë. Këto aktivitete ndihmojnë në zhvillimin fizik, social dhe njohës të fëmijëve, duke i ofruar atyre mundësi për të eksploruar dhe për të mësuar në mënyrë argëtuese dhe të sigurt. Pishina jonë është krijuar posaçërisht për fëmijët e vegjël, me një madhësi të vogël dhe thellësi maksimale prej 60 cm, duke siguruar një ambient të sigurt dhe të përshtatshëm për lojërat me ujë. Ne marrim masa strikte sigurie dhe garantuojmë mbikëqyrje të vazhdueshme gjatë gjithë kohës që fëmijët janë në pishinë, në mënyrë që ata të përfitojnë nga këto aktivitete në një mjedis të mbrojtur dhe të sigurt.

Rëndësia e Lojërave me Ujë në Vitet e Hershme Edukative.

Eksplorim i shqisave: Loja me ujë stimulon shqisat përmes prekjes, tingujve të shpërthimeve dhe lëvizjes vizuale të ujit. Kjo përvojë shqisore mbështet zhvillimin kognitiv dhe ndihmon fëmijët të kuptojnë më mirë botën që i rrethon.

Ndërveprim shoqëror: Aktivitetet në pishinë u japin fëmijëve mundësinë të luajnë së bashku, të ndajnë lodrat, të presin radhën dhe të komunikojnë me njëri-tjetrin. Këto ndërveprime nxisin aftësi të rëndësishme socio-emocionale si empatia, bashkëpunimi dhe vetërregullimi.

Ndërgjegjësim për sigurinë në ujë: Njohja me ujin në një ambient të kontrolluar ndihmon fëmijët të mësojnë parimet bazë të sigurisë që në moshë të vogël. Ata kuptojnë rëndësinë e mbikëqyrjes, qëndrimit brenda zonave të përcaktuara dhe respektimit të rregullave gjatë lojës me ujë.

Ne vëmë përparësi sigurinë dhe mirëqenien e fëmijës tuaj në çdo moment. Për të siguruar një përvojë pozitive për të gjithë fëmijët, ju lutemi të na jepni pëlqimin tuaj që fëmija juaj të marrë pjesë në aktivitetet në pishinën e vogël (swimming/paddling pool).

Faleminderit për bashkëpunimin dhe mbështetjen në pasurimin e udhëtimit mësimor të fëmijës suaj..

Nënshkrimi i prindit/kujdestarit:: _____

Emri i fëmijës:: _____



Pëlqim për Përdorim Komerical të Fotove/Video- ve



As Si pjesë e përkushtimit tonë për të ofruar një ambient të sigurt dhe pasurues për fëmijën tuaj në Wondergarden, ne dokumentojmë momente nga aktivitetet dhe arritjet e tij/saj përmes fotografive dhe videove. Këto kujtime vizuale nuk janë vetëm të çmuara për ju si prindër, por gjithashtu kontribuojnë në materialet tona promovuese dhe praninë tonë online.

Ne e vlerësojmë rëndësinë e respektimit të të drejtave tuaja si prindër/kujdestarë dhe ruajtjen e privatësisë së fëmijës suaj. Prandaj, kërkojmë pëlqimin tuaj për përdorimin komercial të çdo materiali vizual ku mund të shfaqet fëmija juaj. Këto materiale mund të përdoren në faqe interneti, rrjete sociale, broshura, reklama dhe materiale të tjera promovuese.

Unë jap pëlqimin që Wondergarden të përdorë fotografi/video të fëmijës tim për qëllime komerciale, siç përshkruhet më sipër.

Nënshkrimi i prindit/kujdestarit: _____

Date: _____

Gjithashtu, dëshirojmë t'ju informojmë se për sigurinë dhe mbrojtjen e të gjithë fëmijëve dhe stafit, ambientet e **Wondergarden** janë të pajisura me kamera vëzhgimi (CCTV). Këto kamera janë vendosur në mënyrë strategjike, në përputhje me politikën tonë të CCTV-së, e cila përshkruan qëllimin e regjistrimeve si dhe masat e marra për mbrojtjen e të dhënave personale

Duke regjistruar fëmijën tuaj në çerdhen tonë, ju pranoni dhe jeni dakord me praninë e kamerave të sigurisë (CCTV) në ambientet e institucionit.

Për më shumë informacion mbi qëllimin e regjistrimeve dhe rregulloren tonë të përdorimit të CCTV-së, ju inkurajojmë të kërkonit dokumentin përkatës pranë recepsionit ose ta shkarkoni nëpërmjet faqes sonë zyrtare të internetit.



Këshilla për përshtatjen e fëmijës suaj



Largimi i fëmijës suaj nga shtëpia për herë të parë për të shkuar në çerdhe mund të jetë një përvojë sfiduese si për prindërit, ashtu edhe për fëmijët. Këtu janë disa këshilla që mund ta bëjnë këtë kalim më të lehtë:

Përgatitni fëmijën paraprakisht: Flisni me fëmijën tuaj për çfarë është çerdhja, çfarë mund të presë atje dhe siguroni që do të ktheheni ta merrni. Leximi i librave për fillimin e çerdes ose vizitat paraprake në ambientin e çerdes i ndihmojnë të njohin vendin.

Filloni me vizita të shkurtra: Para ditës së parë zyrtare, organizoni qëndrime të shkurtra në çerdhe. Kjo ndihmon fëmijën dhe ju të njiheni me ambientin, edukatorët dhe fëmijët e tjerë gradualisht. Referojuni politikës sonë për "Përgatitjen dhe kalimin në çerdhe" për detaje mbi "seancat e përshtatjes"

Vendosni një rutinë: Krijoni një rutinë të qetë për kohën e largimit dhe marrjes së fëmijës. Konsistenca ndihmon që fëmija të ndihet i sigurt. Përhëndetuni me përqafim dhe buzëqeshje, duke i thënë se do të ktheheni më vonë.

Qëndroni pozitivë: Fëmijët janë shumë të ndjeshëm ndaj emocioneve të prindërve. Mundohuni të qëndroni të qetë dhe pozitiv gjatë largimit, edhe nëse fëmija qau. Sigurojini që çerdhja është një vend ku do të argëtohet, mësojë dhe bëjë miq.

Besoni stafit: Edukatorët tanë janë me përvojë në ndihmën për përshtatjen e fëmijëve në ambientin e ri. Ata do të kujdesen dhe do të ngushëllojnë fëmijën gjatë ditës. Ndani me stafin çdo informacion të rëndësishëm për preferencat, rutinat dhe nevojat e veçanta të fëmijës për një kalim sa më të lehtë.

Inkurajojmë prindërit të telefonojnë për të pyetur për fëmijën nëse kanë shqetësime. Menaxhmenti ose stafi i recepsionit do të jenë të gatshëm të kontrollojnë dhe t'ju japin informacion për qetësimin tuaj.

Festoni arritjet e vogla: Vlerësoni dhe festoni çdo hap të vogël që bën fëmija - qoftë një shok i ri ose pjesëmarrje në një aktivitet. Përforcimi pozitiv i rrit vetëbesimin.

Keni durim: Çdo fëmijë përshtatet në ritmin e tij. Është normale që fillimisht të ketë lot dhe rezistencë. Me kohë, durim dhe konsistencë, fëmijët mësojnë rutinën dhe fillojnë të shijojnë eksperiencën në çerdhe.

Mbani mend, është krejtësisht normale të ndjeni emocione të ndryshme kur lini fëmijën për herë të parë në çerdhe. Bëhuni të mirë me veten dhe besoni se ju dhe fëmija juaj do të përshtateni me këtë kapitull të ri të jetës suaj.



Procesi ynë i përshtatjes (adaptimit)



Sigurimi i mirëqenies së fëmijës tuaj është prioriteti ynë kryesor. Për këtë arsye, kemi krijuar një proces me tri hapa që ndihmon në kalimin e butë nga shtëpia në çerdhe. Këto hapa zhvillohen para ditës së parë të plotë të fëmijës në çerdhe dhe idealisht përfundohen brenda një jave nga përfundimi i të gjitha formaliteteve të regjistrimit.

Hapi 1: Takimi Prind-Edukator

Edukatorja e fëmijës suaj do t'ju kontaktojë për një takim një-për-një, ku do të keni mundësi të ndani informacione të rëndësishme për shëndetin, mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës suaj. Ky takim është gjithashtu një rast për të bërë pyetje ose për të diskutuar çdo shqetësim që mund të keni. Për më tepër, edukatorja do të mbledhë informacion rreth aktiviteteve të preferuara, preferencave dhe rutinave të qetësisë së fëmijës, në mënyrë që të krijojmë një ambient të përshtatur që e mbështet fëmijën tuaj që nga fillimi.

Hapi 2: Seancë e vogël loje familjare në grup

Pas takimit prind-edukatore, do të planifikohet pjesëmarrja e fëmijës suaj në një seancë të vogël loje familjare në grup, së bashku me ju. Kjo do të zhvillohet në klasën e tyre, pranë edukatoreve dhe disa shokëve të klasës. Kjo seancë ndihmon fëmijën të njohë ambientin dhe lehtëson kalimin e tij. Fëmija do të njohë ambientin e ri dhe edukatorët/kujdestarët e tij. Ai/ajo do të zbulojë vendin ku mbahet çanta, vendin për shishen e ujit, do të eksplorojë tualetin dhe do të marrë pjesë në lojëra me shokët e rinj; kjo krijon një ndjenjë rehatie dhe ndihmon fëmijën të përshtatet gradualisht. Ky proces mund të kërkojë një ose dy seanca, secila prej tyre rreth një deri dy orë.

Hapi 3: Seancë e madhe në grup klase

Në fund, edukatorja e fëmijës suaj do të organizojë një seancë më të gjatë dhe me grup më të madh, ku fëmija juaj do të përjetojë për herë të parë eksperiencën solo në çerdhe! Ju jeni të mirëpritur të qëndroni brenda ambienteve të çerddes, por jashtë shikimit të fëmijës. Stafi ynë do të ndihmojë fëmijën tuaj të përshtatet duke u larguar nga ju dhe të krijojë lidhje me ta. Kjo seancë idealisht do të zgjasë 2 deri në 3 orë dhe do t'i ndihmojë fëmijës të pranojë periudha më të gjata larg jush. Gjithashtu, kjo nxit lidhje më të thella mes të gjithë të përfshirëve, duke krijuar një ndjenjë përkatësie për fëmijën dhe promovuar mirëkuptimin reciprok

Pasi të keni përfunduar të gjitha formalitetet e regjistrimit, të keni plotësuar formularin e vlerësimit të zhvillimit dhe të keni përfunduar këtë proces me tri hapa të përshtatjes, ne presim që fëmija juaj të jetë gati të fillojë gradualisht rutinën e plotë të çerddes. Megjithatë, nëse ai/ajo ka nevojë për më shumë kohë për t'u përshtatur, ne do të jemi të gatshëm ta mbështesim këtë nevojë dhe të bashkëpunojmë me ju për këtë.



Dita e Parë në Kopësht

Ju lutemi siguron këto sende, të etiketuara qartë me emrin e fëmijës tuaj, në ditën e parë të kopështit:

Rroba për të ndruar: Pako një set shtesë rrobash, përfshirë edhe rrobat e brendshme dhe çorapet. Këto do të mbahen në kopësht për aksidentet e paevitueshme ose për ndonjë derdhje.



Pelenat /Pull-Ups and Wipes Nëse fëmija juaj nuk është mësuar plotësisht me tualetin, sjellni një sasi të mjaftueshme me pelenat, pull-ups, dhe kremrat sipas nevojës.

Siguria ndaj Alergjive: Për sigurinë e të gjithë fëmijëve, nuk lejohen arra ose ushqime që përmbajnë arra në ushqime, për shkak të alergjive – kjo përfshin gjëra si gjalpi i kikirikut dhe Nutella.

Krem Dielli dhe Kapelë: Gjatë lojërave në oborr, mbrojeni fëmijën nga dielli duke i vënë krem dielli para nisjes për në kopësht dhe duke sjellë një kapelë dielli për mbrojtje shtesë.

Udhëzime të Veçanta ose Alergji: Komunikoni qartë çdo udhëzim të veçantë, kufizim ushqimor ose alergji që ka fëmija juaj tek stafi i kopështit. Çdo medikament që duhet dhënë, duhet të dërgohet drejtpërdrejt te infermierja e kopështit, ku duhet të plotësohet një formular autorizimi për medikamentin.

Dokumentacioni: Sigurohuni që të gjitha dokumentet e nevojshme, si formularët e regjistrimit, kartelat shëndetësore dhe informacioni për kontakte emergjente, të jenë plotësuar dhe sjellë në kopësht.

Inkurajim Pozitiv: Më e rëndësishmja, ofroni shumë inkurajim dhe siguri për fëmijën tuaj. Tregojuni sa krenar jeni për të dhe shprehni gëzimin për ditën e parë në kopësht.



Dieta dhe Ushqyerja e Fëmijëve



Mirembajtja e Dietës dhe Ushqyerja e Fëmijëve në Wondergarden

Në Wondergarden, ne e dimë sa e rëndësishme është ushqyerja e shëndetshme për zhvillimin e fëmijëve tanë. Prandaj, kujdesi për mirëqenien ushqimore të tyre është një nga prioritetet tona kryesore. Për këtë qëllim, kemi angazhuar nutricionisten pediatre Gerta Velu, e cila do të jetë përgjegjëse për hartimin e menusë javore dhe për monitorimin e ushqyerjes së fëmijëve tanë.

Gerta Velu është një nutricioniste e specializuar në ushqyerjen pediatrike, me eksperiencë dhe njohuri të thella mbi nevojat specifike ushqimore të fëmijëve në moshë të hershme. Ajo do të sigurojë që çdo menu të jetë e balancuar, duke përfshirë të gjitha grupet kryesore të ushqimit, si proteina, karbohidrate, yndyra të shëndetshme, fruta dhe perime, duke marrë parasysh gjithashtu nevojat individuale dhe alergjitë e mundshme.

Menutë që do të përgatiten do të jenë të ndryshme dhe të pasura me ushqime të freskëta dhe natyrale, të përshtatura për shijen dhe preferencat e fëmijëve, si dhe për të përkrahur rritjen dhe zhvillimin e tyre optimal. Për më tepër, Gerta do të monitorojë vazhdimisht mirëqenien ushqimore të çdo fëmije, duke bashkëpunuar me prindërit për të adresuar çdo shqetësim dhe për të ofruar këshilla të personalizuara.

Në këtë mënyrë, Wondergarden garanton jo vetëm një ambient të sigurt dhe stimuluese për fëmijët, por edhe një kujdes të veçantë për shëndetin dhe zhvillimin e tyre përmes një diete të shëndetshme dhe të ekuilibruar.



Partneritet me Prindërit



Wondergarden beson se kujdesi cilësor dhe të mësuarit e hershëm i përshtatur për secilin fëmijë kërkojnë një bashkëpunim të ngushtë mes prindërve dhe stafit. Duke e njohur prindin si edukuesin e parë të fëmijës, ne jemi të përkushtuar ta mbështesim këtë rol thelbësor. Komunikimi i hapur dhe i ndjeshëm është thelbësor për ndërtimin e besimit dhe mirëkuptimit në këtë partneritet me prindërit.

Politikat tona synojnë të:

- Njohë dhe mbështesë prindërit si edukuesit e parë të fëmijës dhe t'i integrojë ata në jetën e përditshme të çerdhes.
- Zhvillojë takime fillestare me prindërit për të diskutuar interesat, rutinat dhe çështjet shëndetësore të fëmijës.
- Lehtësojë seancat e provës për një kalim më të butë në ambientin e çerdhes.
- Ofrojë mbështetje të përshtatur për prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta.
- Vë në dispozicion politika dhe procedura të detajuara të çerdhes.
- Mbështesë prindërit në zhvillimin dhe edukimin e tyre përmes trajnimeve dhe punëtorive informuese.
- Krijojë mundësi për ndërveprim dhe përfshirje të prindërve përmes aktiviteteve e ngjarjeve të ndryshme..
- Informojë vazhdimisht prindërit për aktivitetet e çerdhes nëpërmjet buletineve dhe kanaleve online.
- Mbledhë mendimet dhe sugjerimet e prindërve përmes pyetësorëve, takimeve, kutive të sugjerimeve dhe anketave.
- Përgjigjet ndaj komenteve dhe vërejtjeve të prindërve përmes komunikimit të rregullt, duke siguruar që zëri i tyre të dëgjohet dhe vlerësohet.

Për një pasqyrë të plotë të përkushtimit tonë ndaj partneritetit me prindërit, ju ftojmë të vizitoni faqen tonë të internetit.



Wondergarden ne USA është e vlerësuar me:

Early Childhood Education Innovation Award

The winner of US-Based BIZZ Award for Business Excellence

ISO Certifications (9001 - , 14001 - 45001) - standarde ndërkombëtare.

KinderCare Education Legacy Awards - për arritje në edukimin e hershëm (SHBA).

Global Excellence Awards in Education.



“Duke mbjellë farat e suksesit”

Standardet tona të cilësisë dhe kujdesi i përkushtuar bëjnë që Wondergarden të jetë partneri i preferuar për zhvillimin dhe mbështetjen e çdo fëmije.

Ask the team at your branch for more information



